

Nr.regj.30754/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Arben Bajramaj nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73,74,195,199 dhe nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë **28.12.2012** merr këtë:

AKTVENDIM

DPK/DMP

03-180/2013

I PANDEHURI: Arben Islam Bajramaj, i lindur më 27.04.1977 në Pejë, tani jeton në Prishtinë, me vendbanim në lagjen Mati I, rruga "Ahmet Krasniqi" nr.35, me shkollim superior, i punësuar në Ndërmarrjen Publike Basnesore në Prishtinë (NPB), i martuar, babë i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike,

02

28-01-2013

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, duke qenë Zyrtar i Lartë Publik, në pozitë të u.d.së Zyrtarit Financiar dhe të Thesarit në Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, andaj për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro), të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **13 ditësh**, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është e obliguar të paguaj shumën prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës. Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrroi kësaj gjykate Kërkesën Nr. 01-2495/2012 me datë 30.07.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen nga neni 5.6 paragrafi 1.3 dhe neni 9, ndëshkuar me nejin 17 paragr.1.3 të ligjit 04/L050.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se vërtetë nuk e ka bërë deklarimin e rregullt të pasurisë deri më datë 31.03.2012, për arsye se kishte dilemë nëse duhet apo jo të deklarojë pasurinë, meqë kishte qenë në pozitë të ushtruesit të detyrës së zyrtarit kryesor financiar dhe të thesarit në NPB nga data 05.07.2011 deri më 15.03.2012 duke e zëvendësuar kolegen e tij e cila ka qenë në pushim të lehonisë e cila është kthyer më datë 15.03.2012, derisa i njëjti vazhdon të punojë në pozitë të udhëheqësit të shërbimit të kontabilitetit, kurse nga zyrtari kontaktues i NPB nuk ka qenë i njoftuar për obligimin e deklarimit të pasurisë dhe listën e dërguar në AKK ku është edhe emri i tij, por siç deklaroi i njëjti i kishte thënë se nuk ka nevojë të bëjë deklarim të pasurisë. Në vazhdim i pandehuri deklaroi se nuk ka pasur ndonjë kërkesë të veçantë nga zyrtarët e AKK për deklarim të pasurisë dhe

se nuk ka pasur arsye për mosdeklarim të pasurisë përveç dilemës nëse duhet apo jo të deklarojë pasurinë. Në fund prezanton një provë, Njoftim të datës 22.08.2012 drejtuar nga NPB në AKK.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, gjyqtarja dëgjoi edhe parashtruesin e kërkesës, zyrtarin nga AKK, në cilësi të dëshmitarit, i cili deklaroi se zyrtari i lartë publik ka pasur obligim të deklarojë pasurinë për periudhën paraprake prej kur është caktuar të kryejë punët e zyrtarit kryesor për financa e thesar, pavarësisht nëse ka qëndruar deri në gjysmë të muajit mars 2012 apo deri në fund të muajit mars 2012 dhe se i njëjti ka pasur obligim të deklarojë pasurinë për herë të parë, andaj edhe AKK e kishte ngarkuar me nenin 9 të Ligjit 04/L050, ndonëse bëhej fjalë për deklarim të rregullt të pasurisë. Gjyqtarja, mëtutje dëgjoi edhe zyrtarin kontaktues të NPB, gjithashtu në cilësi të dëshmitarit, i cili deklaroi se me datë 21.02.2012 në AKK e kishte dërgur listën me emra të zyrtarëve të lartë në të cilën e kishte shënuar edhe emrin e Arben Bajramaj si zyrtar i cili e zëvendëson zyrtaren në pushim të lehonisë, ndërsa më vonë me datë 01.03.2012 kishte pranuar njoftimin nga AKK për obligimin e deklarimit të pasurisë deri më datë 31.03.2012 për të gjithë zyrtarët e lartë të përfshirë në listë ku ishte edhe emri i Arben Bajramaj si ud.i detyrës përkatëse, me të cilin njoftim i kishte njoftuar të gjithë zyrtarët përfshirë edhe Arben Bajramajn. Në fund thekson se një zyrtarë nga AKK i kishte thënë se Arben Bajramaj nuk ka nevojë të deklarojë pasurinë dhe se këtë thënie ia kishte përcjellur Arben Bajramajt, për çka si dëshmi prezanton një korrespondencë elektronike nga AKK.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, dëshmitarëve, shqyrtimi i provës materiale dhe i shkresave të tjera të lëndës, administrimi i secilës veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë së të pandehurit për këtë kundërvajtje meqë i njëjti siç thekson zyrtari kontaktues i NPB ka qenë i njoftuar me njoftimin e AKK për deklarim të pasurisë dhe për afatin e fundit deri më 31.03.2012, pra ka qenë në dijeni për obligimin ligjor të deklarimit të pasurisë, ligjërisht të qenunit ushtrues detyre nuk e liron zyrtarin nga përgjegjësia për deklarim të rregullt të pasurisë dhe se ky lloj deklarimi ka të bëjë me periudhën paraprake e deri në fund të muajit mars, të cilin deklarim i pandehuri e ka anashkaluar duke mos i kushtuar rëndësinë e duhur. Sa i përket provës, Njoftimit të datës 22.08.2012 gjyqtarja vlerësoi se ky njoftim është vetëm shkrim për arsyetim, i adresuar AKK pas marrjes së njoftimit nga AKK se është iniciuar procedura kundërvajtëse. Ndërsa provës materiale të prezantuar nga zyrtari kontaktues i NPB, korrespondencës elektronike, gjyqtarja nuk ia fali besimin meqë e njëjta nuk kishte të bëjë aspak me thënien e zyrtares nga AKK se, Arben Bajramaj nuk ka nevojë të deklarojë pasurinë, këtë fakt gjyqtarja e konsideroi vetëm si tendencë që në një mënyrë apo tjetër të arsyetojë kolegun Arben Bajramaj. Andaj, bëri rikualifikim të kundërvajtjes duke e ngarkuar për mosdeklarim të rregullt të pasurisë nga neni 8 në nenin 9 e ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të ligjit 04/L-050, e që është më i favorshëm për të pandehurin dhe, në aplikim të nenit 9 të LK i shqiptoi dënimin nën minimumin e paraparë ligjor.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe sipas peshës së kundërvajtjes e shkallës së përgjegjësisë së pandehurit, të njëjtin e dënoi me dënim me gjobë të zbutur të precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
 Nr.regj.30754/2012, datë 28.12.2012

Gjyqtarja
 Suzana Çerkini



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.